



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Përgjegjësia penale e personave juridik

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Përgjegjësia penale e personave juridik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV-të, semestri i VII-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	Ligjërata: Ushtrime Asistent: Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Fejzullah Hasani
Detajet kontaktuese:	fhasani60@hotmail.com, tel: 045-321-690
Përshkrimi i lëndës	<i>Përgjegjësia penale e personave juridik, është lëndë obligative për studentët e vitit të IV-të të Fakultetit Juridik.</i> Fitimi i njohurive për përgjegjësinë penale të personave juridik në përgjithësi, karakteristikat e përgjegjësisë penale të personave juridik, bazat dhe kufijtë e përgjegjësisë penale të personave juridik, dënimet dhe seksionet tjera penalo-juridike ndaj këtyre personave, matja e dënimit për personat juridik, pushimi i personit juridik, dënimi me kusht ndaj personave juridik, masat e sigurisë për personat juridik, parashkrimi i ndjekjes penale dhe sanksionit penal për personat juridik, evidenca ndëshkimore për këta persona për pasojat juridike për këta persona, zbatimi subsidiar i dispozitave të KPPK-ës. Në kuadër të kësaj lënde, studentët do të fitojnë edhe njohuri për procedurën penale ndaj personave juridik (pjesën procedurale), duke përfshirë kompetencat, përfaqësimin, shpenzimet e përfaqësuesit, mbrojtësit, aktet akuzuese dhe përmbajtje të tyre,

	vendimet gjyqësore, mjetet juridike si dhe vendimet sipas mjeteve juridike.
Qëllimet e lëndës:	Në fund të semestrit studentët do të fitojnë njohuri teorike dhe praktike, për pjesën materiale penale dhe atë procedurale, kur kemi të bëjmë me personat juridik, të cilët gjatë punës së tyre kanë vepruar në kundërshtim me ligjin.
Rezultatet e pritura të nxënies:	1. Të fitoj njohuri për subjektet juridike dhe statusin e tyre në aspektin penalo-juridik; 2. Kur personat juridik mund t'i nënshtrohen përgjegjësisë penale; 3. Forma e fajësisë të personat juridik; 4. Parimet e fajësisë; 5. Cilat dënime mund t'u shqiptohen personave juridik; 6. Specifikat e procedurës penale në raport me personin juridik; 7. Aspekti ligjor i përgjegjësisë penale të personave juridik si dhe 8. Aspekti krahasimor i përgjegjësisë penale të personave juridik.

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1	3
Ushtrime teorike	1	1	1
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	Lidhur me rezultatet e provimit dhe testeve	1
Kollokfiime(2), seminare (1 sipas dëshirës së studentit	2x1		2x1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata të përcaktuara sipas plan-programit, punë seminarike, prezantimet nga vet studentët, komunikimet interaktive gjatë zbatimeve të ushtrimeve. Ligjërata interaktive: Bashkëbisedim-duke ju mundësuar studentëve parashtrimin e pyetjeve, diskutimin dhe këmbimin e mendimeve të tyre lidhur me çështjet e ndryshme tematike Punime seminarike: Aktivitete të studentëve. Studentët mund të përcaktohen për studimin e ndonjë teme apo punimi seminari. Para fillimit të punës së tyre atyre ju ofrohen udhëzimet elementare, ndërsa pas përfundimit ju ofrohet mundësia e prezantimit të punimeve të tyre para studenteve të tjerë. Pas prezantimit të këtyre seminareve zhvillohet debat interaktiv lidhur me temat e shtjelluara dhe në fund behet vlerësimi i punimit. Puna grupore: Debat shkencorë. Gjatë trajtimit të temave të ndryshme, studentët mund të ndahen në dy ose më shumë grupe, më qëllim të zhvillimit të debateve interaktive dhe konstruktive shkencore Metodat e ligjërimit: Zakonisht do të aplikohen metoda bashkëkohore të ligjërimit, të cilat praktikohen në universitetet e ndryshme evropiane: prezantimi i temës përmes Power Point, raste studimi dhe detyra mësimore – studimore lidhur me temën e ligjëruar.

Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj) 15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	1. Prof. Dr. Ismet Salihu, <i>E drejta penale-pjesa e përgjithshme</i> ; 2. Pro. Asoc. Dr. Azem Hajdari, <i>E drejta e procedurës penale</i> dhe 2. Ligji me nr. 04/L-030, Për përgjegjësinë penale të personave juridik për vepra penale
Literatura shtesë:	1. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, 2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës
Plani i dizajnuar i mësimi:	
JAVA	Ligjërata që do të zhvillohet
JAVA E PARË: (tetori)	PËRGJEGJËSIA PENALE GJATË HISTORISË PËR PERSONAT JURIDIK - përgjegjësia penale e personave juridik në periudhën romake, - mesjetë, - në kohën bashkëkohore Baza juridike ndërkombëtare dhe nacionale lidhur me përgjegjësinë penale të personave juridik
JAVA E DYTË:	SUPOZIMET E FAJËSISË - BAZAT DHE KUFIRI I PËRGJEGJËSISË PENALE TË PERSONAVE JURIDIK PËRGJEGJËSIA NË RAST NDRYSHIMI TË STATUSIT DHE FALIMENTIMIT TË PERSONIT JURIDIK, TENTATIVA E VEPRËS PENALE
JAVA E TREË	DËNIMET DHE SANKSIONET PENALE - DËNIMI ME GJOBË, - MATJA E DËNIMIT ME GJOBË, - DËNIMI ME PUSHIM TË VEPRIMTARISË SË PERSONIT JURIDIK, - DËNIMI ME KUSHT
JAVA E KATËRT: (nëntori)	DËNIMI ME KUSHT - KUR MUND TË SHQIPTOHET DËNIMI ME KUSHT,

	MASAT E SIGURISË 1. NDALIMI I KRYERJES SË VEPRIMTARIVE DHE PUNËVE TË CAKTUARA; 2. MARRJA E SENDIT; 3. KONFISKIMI E DOBISË PASURORE; 4. SHPALLJA PUBLIKISHT E AKTGJYKIMIT.
JAVA E PESTË:	PARASHKRIMI PARASHKRIMI I NDJEKJES PENALE, KUR NUK MUND TË NDËRMERRET NDJEKJA PENALE, PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT
JAVA E GJASHTË:	KOLLOKFIMI I PARË
JAVA E SHTATË:	EVIDENCA PËR DËNIMET E SHQIPTUARA - KUSH I MBANË EVIDNECAT PËR DËNIMIN E PERSONIT JURIDIK, - ÇKA PËRMBANË EVIDNECA , - KUJT MUND TI JEPEN KËTO EVIDENCA
JAVA E TETË:	PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMIT - CILAT JANË PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMIT - KOHËZGJTJA E PASOJAVE JURIDIKE TË DËNIMIT, - KUR MUND TË SHUHEN PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMIT
JAVA E NËNTË: (dhjetori)	ZBATIMI SUBSIDIAR I DISPOZITAVE TË PJESËS SË PËRGJITHSHME TË KODIT PENAL 1. VEPRËN PENALE; 2. VEPRËS SË RËNDËSISË SË VOGËL; 3. NEVOJËS EKSTREME; 4. SHTYTJES; 5. NDIHMËS; 6. KUFIJTË E PËRGJEGJËSISË PENALE DHE NDËSHKIMI PËR BASHKËPUNIM; 7. MËNYRA E KRYERJES SË VEPRAVE PENALE; 8. KOHA E KRYERJES SË VEPRAVE PENALE; 9. VENDI I KRYERJES SË VEPRAVE PENALE; 10. QËLLIMI I DËNIMIT ME KUSHT; 11. REVOKIMI I DËNIMIT ME KUSHT PËR SHKAK TË VEPRAVE PENALE TË KRYERA MË PARË;

	12. REVOKIMI I DËNIMIT ME KUSHT PËR SHKAK TË MOS PËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE TË CAKTUARA; 13. AFATET PËR REVOKIMIN E DËNIMIT ME KUSHT; 14. FILLIMI DHE NDËRPRERJA E AFATEVE TË PARASHKRIMIT TË NDJEKJES PENALE; 15. FILLIMI DHE NDËRPRERJA E AFATEVE TË PARASHKRIMEVE TË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE; 16. DOMETHËNIA E SHPREHJEVE.
JAVA E DHJETË:	PROCEDURA PROCEDURA UNIKE, KOMPETENCA TERRITORIALE, PËRFAQSUESI I PERSONIT JURIDIK , CAKTIMI PËRFAQESUSIT, ROLI I PËRFAQESUESIT, SJELLJA ME DETYRIM E PËRFAQSUESIT, SHPENZIMET E PËRFAQESUESIT
JAVA E NJËMBËDHJETË:	MBROJTËSI
JAVA E DYMBËDHJETË:	KALLZIMI PENAL, REFUZIMI KALLËZIMIT PENAL, NJOFTIMI I TË DËMTURIT NGA ANA E PROKURORIT TË SHTETIT
JAVA E TREMBËDHJETË: (janari)	AKTAKUAZA - PËRMBAJTJA E AKTAKUZËS, - SHQYRTIMI KRYESOR LIDHUR ME PËRGJEGJSINË PENALE TË PERSONAVE JURIDIK, - SI RRJEDHË SEANCA KRYESORE, - BALALFAQIMI , - PËRMBAJTJA E AKTGJYKIMIT, - MJETET JURIDIKE , - VENDIMET E GJYKATËS SË AELIT, MASAT E KUJDESIT NDAJ PERSONIT JURIDIK, ZBATIMI I KPPK-ËS DHE LIGJIT PËR EKZEKUTIMIN E SANKSIONEVE PENALE
JAVA E KATËRMBËDHJETË	KOLLOKFIUMI I DYTË